



Monoteizmi dhe origjina e shkencave natyrore

Description

Mark Worthing, Dr.phil., Dr.theol.

Hyrje

Në klimën bashkëkohore intelektuale, shpesh supozohet se ata që kanë besim në Zot duhet ta kapërcejnë këtë pengesë për të punuar në shkencë dhe duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm që të mos lejojnë presupozimet e tyre të lëkundin kërkimin e tyre shkencor. Në një farë mënyre supozohet se vetëm ata me përkushtim fetar mbartin me vete supozime në kërkimin e tyre shkencor. Dhe më tej supozohet se shkencë dhe kërkimi shkencor janë antiteza të besimit dhe se feja, veçanërisht krishterimi, ka qenë një pengesë për zhvillimin e shkencës moderne dhe është dashur të kapërcehet. Realiteti është se asnjë nga këto supozime nuk ka qenë në gjendje të demonstrohet nga kërkimet në historinë e shkencës. Në realitet, krejt e kundërta është dëshmuar si e vërtetë. Periudhat më të mëdha të rritjes në shkencë kanë ndodhur në kohëra, rajone dhe individë me angazhime besimi monoteist. A është kjo thjesht rastësi, apo provat historike sugjerojnë se monoteizmi ndihmoi disi në lindjen e shkencës moderne dhe kulturës kërkimore të lidhur me të? Aspektet historike të këtij argumenti janë bërë në shumë vende. Ajo që besoj se meriton diskutim të mëtejshëm janë aspektet filozofike të argumentit.

Pjesa e parë: Një taksonomi e shkurtër e teorive në lidhje me marrëdhënien ndërmjet monoteizmi dhe ngritjes së shkencës

Edukimi im i hershëm fetar ka qenë ai i një të krishteri konservator protestant. Shkencat natyrore përgjithësisht shiheshin në një këndvështrim negativ si një kërcënim për besimin fetar. Sigurisht që nuk mund të kujtoj që asnjë nga mësuesit e mi të hershëm fetar të ketë sugjeruar se krishterimi ose ndonjë traditë tjetër fetare mund të kenë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shkencave natyrore. Në kontekstin e edukimit tim fetar, një ide e tillë do të ishte absurde. Pikëpamja ime për shkencën dhe fenë mund të ketë qenë dikotomike, por ishte e qartë dhe e lehtë për t'u kuptuar. Për sa më përkiste mua, kjo ishte pika e vetme për të cilën udhëheqësit fetarë dhe shkencëtarët pajtoheshin: Shkenca dhe feja janë kundërshtarë të natyrshëm. Ashtu si shumica e të rinjve me një sfond të tillë, botëkuptimi im për shkencën dhe fenë filloi të shpërbëhej në universitet. Dukej se ndoshta shkenca nuk ishte domosdoshmërisht armiku i besimit; se një përkushtim serioz ndaj besimit në Zotin si krijues nënkuptonte një interes më shumë se kalimtar për njohuritë e botës natyrore^[1] dhe se prespektiva se shkenca dhe feja janë armiq, të cilën unë e kisha pranuar si shumë evidente për t'u vënë në dyshim, kishte historinë e vet të dyshimtë. Ajo që vijon është një vështrim i shkurtër i kuptimeve të ndryshme të marrëdhënies midis fesë, veçanërisht traditave monoteiste, dhe daljes së shkencave natyrore.

Shkenca lind pavarësisht kundërshtimit nga feja: Teza e Draper-White

Shfaqja e librit të Charles Darvinit të vitit 1859, Origjina e Specieve, pati një ndikim të thellë, nëse jo të menjëhershëm, në marrëdhëniet midis teologjisë së krishterë dhe shkencave natyrore. I gjithë debati mbi Darwinin ndikoi shkrimtarë të tillë si John William Draper (Historia e Konfliktit midis Fesë dhe Shkencës, 1875) dhe Andrew Dickson White (Një histori e luftës së shkencës me teologjinë në të ashtuquajturin krishterim, 1896) të cilët portretizuan të gjithë historinë e zhvillimit të shkencës si një luftë kundër një krishterimi fanatik dhe mendjengushtë, i cili i frikësohej shkencës dhe po rrethohej nga përparimi i saj. Draper, duke paralajmëruar për një konflikt të intensifikuar midis shkencës dhe fesë, e përfundon librin e tij me

paralajmërim se:

Besimi duhet të justifikojë veten para arsyes. Misteret duhet t'i lënë vend fakteve. Feja duhet të heqë dorë nga ajo ... pozitë dominuese që ka mbajtur kaq gjatë kundër shkencës. ... eklezia duhet të mësojë ta mbajë veten brenda fushës që ka zgjedhur dhe të pushojë së treguari tiranik ndaj filozofit [natyror], i cili, i vetëdijshëm për forcën dhe pastërtinë e motiveve të tij, nuk do ta duroj më një ndërhyrje të tillë.^[2]

Edhe White, pikëpamjet e të cilit ishin disi më të moderuara se ato të Draper, i portretizoi konfliktet e ndryshme midis teologjisë dhe shkencës, reale dhe imagjinare, si çështje të njëanshme në të cilat një

strukturë kishtarë agresive dhe mbizotëruese kërkon vazhdimisht të shtypë një shkencë të pastër dhe kërkuese të vërtetës si edhe praktikuesit e saj modest.^[3]

Modeli i luftës (ndërmjet fesë dhe shkencës) i Draper dhe White ka pasur pasoja të gjera. Nga ky model, për shembull, lindi pikëpamja ende popullore se Koperniku e ndaloi botimin e tij *De Revolutionibus* nga frika e persekutimit nga kisha. Megjithatë, Koperniku, vetë një zyrtar i vogël i kishës, i kishte përshkruar tashmë pikëpamjet e tij vite përpara vdekjes së tij në komentin e shkurtër *Commentariolus*. I vetmi presion që Koperniku duket se ka marrë nga zyrtarët e kishës erdhi nga disa anëtarë të Universitetit Lutheran të Wittenbergut (ku Martin Luteri ishte në atë kohë duke dhënë mësim) dhe nga Kardinali Schönberg, në një letër drejtuar Kopernikut të datës 1536. Të dyja burimet e nxitën atë të botonte një përshkrim të plotë të teorisë së tij në mënyrë që të mund të studiohej. Në fakt, Fred Hoyle, aspak një mik i vetë fesë së organizuar, pranoi se “faktorët që e penguan Kopernikun [nga botimi] duhet të kenë qenë ose shkencore ose personale të tijat.”^[4] Megjithatë, imazhi i një astronomi revolucionar i frikësuar nga reagimi i kishës ndaj teorisë së tij vazhdon.

Çështja Galileo, detajet aktuale të së cilës janë mjaft të sikletshme për kishën, u riinterpretuan [nga narrativa e konfliktit fe-shkencë, shën. i përk]. U injorua konflikti personal midis Galileos dhe mbështetësit të tij të dikurshëm, Papa Urban VII; lidhjet pro-spanjolle të Galileos në një kohë kur Spanja po ushtronte presion mbi papatin dhe, ndoshta më e rëndësishmja, fakti që Galileo ishte kaq i frustruar nga argumentet e Papës kundër teorisë së Kopernikut, të cilat ai i ndau me Galileon gjatë një bisedë personale me të, sa që në librin e tij të ardhshëm Galileou i vuri argumentet e Papës në gojën e budallait Simplicius. Por ndoshta më intriguese nga të gjitha ishte suksesi i përpjekjes (nga përkrahësit e tezës së konfliktit, shën. i përk.) për t’i atribuar kishës besëtytninë mesjetare, të besuar në disa qarqe, se toka ishte e sheshtë. Në të vërtetë, edhe sot shumë shkencëtarë dhe jo pak teologë paralajmërojnë kundër kthimit në ditët kur kisha mbante qendrimin se toka ishte e sheshtë. Problemi i vetëm është se as kisha dhe as ndonjë nga mësuesit e saj nuk mbajtën ndonjëherë qendrimin se toka është e sheshtë. Diagramet mesjetare të botës e portretizonin atë si një rreth dhe tekstet e filozofisë dhe teologjisë flisnin për të si të rrumbullakët ose si një sferë.

Megjithatë, paçka dokumentacionit shpeshherë të dobët dhe paragjykimin e dukshëm të tezës Draper-White, si dhe refuzimin e saj përfundimtar nga historianët më të respektuar të fesë dhe shkencës, teza në fjalë përmbante një masë të mjaftueshme të së vërtetës për të mbajtur ndikimin dhe ngjyrën e saj, deri më sot. Teza e Draper-White është ende pikëpamja e shumë individëve brenda bashkësisë shkencore dhe fetare.

Shkenca moderne doli në dritë në Anglinë puritane

Nëse teza Draper-White nuk ka bazë, atëherë a mund të ketë ngjarë që feja jo vetëm që nuk i rezistoi rritjes së shkencës, por edhe luajti një rol pozitiv në zhvillimin e saj? Një ndryshim – të paktën në botën e vogël intelektuale dhe fetare që kam përjetuar në rini – po merrte jetë. Shumë mendimtarë fetarë dhe një numër shkencëtarësh besimtarë, po sfidonin idenë se shkenca ishte armiku, madje duke sugjeruar se ishte një mik i mundshëm. Ndërsa kjo pikëpamje fitoi terren, dukej se po ashtu morën terren edhe

përpjekjet për të marrë merita për ngritjen e shkencës. Midis 1938 dhe 1975 u shfaqën të paktën tre monografi të veçanta që argumentonin se shkencë moderne ia detyronte origjinën e saj jo vetëm fesë, jo vetëm monoteizmit, jo vetëm krishterimit, jo vetëm protestantizmit, jo vetëm protestantizmit të reformuar, por veçanërisht puritanizmit protestant anglez.^[5] Dhe një vepër e katërt, vepra shumë me ndikim e R. Hooykaas, *Religion and Rise of Modern Science*, i kushtoi vëmendje rolit të puritanëve anglezë, por argumentoi se ishte kalvinizmi në përgjithësi dhe e ashtuquajtura etikë e punës protestante së cilës shkencë moderne ia detyron fillimin e saj.^[6] Ndërsa kishte një sërë kontributesh kryesore që dolën nga Anglia e shekullit të 17-të, dhe ndërsa shumë nga këta individë, jo çuditërisht, patën një ndikim puritan, siç shihet për shembull në përfaqësimin dhe ndikimin e fortë puritan në themelimin e Shoqërisë Mbretërore të Londrës, në 1660, të krishterët e tjerë kishin të drejtë të mendonin se kjo tezë ishte paska e ekzagjeruar.

Shkencë doli nga Reforma Protestante

Të tjerë kanë argumentuar më gjerësisht se protestantizmi në përgjithësi hodhi themelet për ngritjen e shkencës moderne. Është e qartë se Luteri kishte disa pikëpamje të favorshme ndaj shkencave natyrore si disiplina të pavarura tashmë në fillim të shekullit të 16-të dhe kolegët e tij në Universitetin e Wittenberg përfshinin disa nga mbështetësit më të hershëm të Kopernikut.^[7] Pavarësisht disa besimeve mesjetare mjaft të sikletshme për gjëra të tilla si gjenerimi spontan i minjve dhe brumbujve të plehut, dhe pikëpamjes së tij se zogjtë i mbijetonin dimrit të ngrirë në ujë të akullt, Luteri e kishte shumë të qartë se studimi i natyrës kishte meritë në vetvete dhe duhej të ishte i pavarur nga studimi i teologjisë.^[8]

Profesori australian i filozofisë Peter Harrison, në librin e tij *Bibla, Protestantizmi dhe Ngritja e Shkencës Natyrore* (*The Bible, Protestantism and the Rise of Natural Science*), argumenton se theksi i veçantë protestant në studimin dhe interpretimin e teksteve të shenjta përcaktoi një metodologji që çoi fare natyrshëm në hetimin shkencor të botës natyrore.^[9] Kjo teori, jo çuditërisht ishte më e pranueshme për shumicën e protestantëve sesa teoria që e shihte Anglinë puritane si arsyen për ngritjen e shkencës moderne. Teoria e protestantizmit do të thoshte gjithashtu se historiani i shkencës (në mënyrë që të shpjegonte rolin e monoteizmit në ngritjen e shkencës) nuk duhet të kërkonte atë që ishte unike për puritanizmin anglez, por atë që ishte unike për protestantizmin. Si një protestant jo i reformuar (luteran), kjo teori ishte shumë më tërheqëse dhe më e kënaqshme për mua. Megjithatë, nuk kaloi shumë kohë para se të zbuloja një problem me tezën se protestantizmi qendronte pas ngritjes së shkencës moderne.

Shkencë doli në pah falë si shkak i katolicizmit mesjetar dhe Rilindjes Evropiane

Kjo pikëpamje tregon ndikimin e shkollave të manastireve dhe katedrales, në të cilat mësohej mjekësia dhe filozofia natyrore, si dhe teologjia, dhe nga të cilat dolën universitetet e hershme evropiane. Ajo tregon për rolin e Albertus Magnus dhe Thomas Aquinas në përshtatjen e filozofisë aristoteliane me

mendimin e krishterë. Ajo thekson se Koperniku dhe Galileo, ndër të tjera, ishin pjesë e kishës katolike dhe se shoqëria e parë shkencore në Evropë ishte shoqëria katolike Linus në Itali.

Shkenca doli nga perëndimi i krishterë, si protestant ashtu edhe katolik

Dukej se katolikët, gjithashtu, kishin luajtur një rol të hershëm dhe kyç në zhvillimin e shkencës moderne në Evropë. Koperniku kishte qenë një klerik i rangut të ulët që vdiq në gjendje të mirë me kishën dhe Galileo, pavarësisht mosmarrëveshjeve të tij me hierarkinë e kishës, kurrë nuk e pa veten si diçka tjetër veçse si një i krishterë katolik. Shoqëria e parë e njohur shkencore e themeluar në Evropën e krishterë, doli se nuk ishte Shoqëria Mbretërore e Londrës në 1660, por Akademia Katolike Italiane Lincean e themeluar në vitin 1603. Dhe ndërsa puritanët e shekullit të 17-të kishin dhënë kontribute të rëndësishme në shkencë, ata ishin barazuar nga jezuitët gjatë së njëjtës periudhë. Ajo që del nga e gjithë kjo është se, pavarësisht nga ndikimet e ndryshme pozitive specifike për të menduarit protestant dhe katolik në shekujt 16-të dhe 17-të, revolucioni shkencor në Evropë dhe zhvillimi i mëpasshëm i shkencës moderne siç e njohim ne do të kishte ndodhur sipas të gjitha gjasave me ose pa një reformim protestant ose kundër-reformim katolik.^[10] Tani sfida ishte të gjendej diçka e dallueshme për të ashtuquajturin krishtërim perëndimor dhe t'i atribuohet merita për ngritjen e shkencës brenda traditës së krishterë në përgjithësi. Është e qartë se etika protestante e punës dhe qasja ndaj ekzegjës biblike, sado me ndikim mund të kenë qenë këto elementë për disa mendimtarë, nuk ishin në gjendje të shpjegojnë ngritjen e shkencës. Megjithatë, kjo narrative e kontributit fetar në origjinën e shkencës natyrore dështon në shpjegimin e plotë të fenomenit. Pikësëpari, ajo mbështetet në përcaktimin e shkencës në atë mënyrë që ne kërkojmë të shpjegojmë vetëm llojin e qasjes shkencore dhe rezultateve të tipizuara nga Evropa Perëndimore në shekujt 16-të dhe 17-të. Kur shikojmë më në themel se çfarë është shkenca dhe presupozimet filozofike dhe metodologjike që qëndrojnë në zemër të saj, tabloja shpejt bëhet shumë më komplekse.

Shkenca moderne doli në pah për shkak të ndikimit të Judaizmit dhe ligjërit Talmudik

Tradita më e vjetër brenda besimeve monoteiste abrahamike (judaizmi) ka pretenduar, më pak se të gjitha traditat e tjera, se është përgjegjëse për ngritjen e shkencës. Megjithatë, është vënë re se shumë nga tiparet e mendimit të krishterë dhe islam që mund të kenë ndihmuar ngritjen e shkencës e kanë origjinën në judaizëm. Vihet re ndikimi i filozofëve, mjekëve dhe shkencëtarëve hebrenj përgjatë të ashtuquajturit krishtërim mesjetar dhe islamit të hershëm, si dhe numri i konsiderueshëm i shkencëtarëve hebrenj. Është sugjeruar se metoda Talmudike e argumentimit dhe ndërveprimi me besimet e tjera gjatë shekujve të të jetuarit në diasporë të hebrenjve, kontribuan në një hapje ndaj të menduarit kritik që luajti një rol kyç në ngritjen e shkencës^[11].

Shkenca filloi ngritjen e saj në mendimin islam

Kur merret parasysh roli i filozofisë greke, dhe veçanërisht i Aristotelit, zbulojmë menjëherë në botën islame ekzistencën një botë të menduarit dhe zbulimit shkencor që ishte shekuj përpara Evropës perëndimore të krishterë. Filozofët dhe shkencëtarët myslimanë si Ebu 'Al? Ibn S?na (Avicena v. 1037) dhe Al? Ibn al-Hejthen ('Alhazen) (965-1039) ishin shumë më tepër se pararendës të thjeshtë të shkencës moderne në metodologjitë dhe rezultatet e tyre. Shekuj përpara se shkenca të fillonte të përhapej në Perëndimin e krishterë, ishin bërë përparime të jashtëzakonshme nga studiues myslimanë, të cilët ishin përfitues jo vetëm të punës së filozofëve grekë, por gjithashtu zotëronin veprat e përkthyer të kulturave të tjera. Në filozofi, përveç Ibn Sina-s (i cili ishte gjithashtu një mjek i njohur), shquhen el-Kind? dhe el-F?r?b? dhe Averroes. Persiani Ebu Bakr El R?z?, i famshëm për njohuritë e tij në mjekësi, mbahet mend për kontributet e tij origjinale në këtë fushë dhe për koleksionin e tij të njohurive mjekësore indiane, greke dhe të Lindjes së Mesme. Xhabir Ibn Hajan mbahet mend për atë që tani e quajmë kimi – megjithëse kjo shkencë në atë kohë shpesh bashkëjetonte me alkiminë. Al-Hejthen, al-Khauarizmi, Th?bit Ibn Kurrah, Omar Khajam dhe Ben? Shak?r ishin matematikanë ekspertë. Në fushën e astronomisë dhe kozmologjisë, Ebu Ma'shar El-Balkh?, El-Battani, Ibn Junis dhe Abdurrahman el-S?f? ishin të gjithë të njohur. Qendrat e të mësuarit shkencor ekzistonin në këtë periudhë nga Kordova në Perëndim, Kajro në Egjipt deri në Bagdad dhe Basra. Gjerësia dhe thellësia e njohurive shkencore të ekspozuara nga shekulli i dhjetë deri në atë të trembëdhjetë, brenda botës muslimane, ishte e pashembullt deri në atë kohë.[\[12\]](#)

Midis këtyre Ibn Al-Hejthen, ose `Alhazen, është një shembull i shkëlqyer i gjendjes së kërkimit shkencor në Islam, në fillim të mijëvjeçarit të dytë të erës sonë. Alhazen ishte një matematikan, fizikan dhe astronom i arrirë. Ai ishte gjithashtu një pionier në fushën e optikës, duke demonstruar se Euklidi dhe Ptolemeu kishin gabuar në lidhje me tezën e tyre se syri dërgonte rreze drite për të parë objektet, sipas tij, në të vërtetë syri merrte rreze drite nga objektet e shikuara. Por nuk ishin vetëm aftësitë e tij teknike ato që e bënin të dallohej. Ai shqyrtoi pa pushim dhe vuri në dyshim teoritë ekzistuese, duke hedhur poshtë ato që nuk përputheshin me të dhënat fizike. Ai zhvilloi një metodë induktive të artikuluar shekuj përpara Bacon dhe përcaktoi hapat për formulimin dhe verifikimin e hipotezave. Pyetjet që ai bëri për botën natyrore ishin të qëllimshme dhe sistematike. Ai parashikoi shumë arritje të shkencës perëndimore të paktën gjashtë shekuj më herët, jo vetëm në fushën e njohurive teknike, por edhe në mënyrë më kritike në metodologji. Duke parë arritjet e tij sot bien në sy dy gjëra. Së pari, se ai nuk ishte i vetëm, por ishte i rrethuar nga një numër bashkëkohësish apo pothuajse bashkëkohësish, të cilët bënë përparime të jashtëzakonshme në fushat e tyre të kërkimit. Dhe së dyti, se ai ashtu edhe bashkëmoshatarët e tij janë të padëgjuar nga shumë shkencëtarë dhe historianë perëndimorë të shkencës.

Epoka e artë e filozofisë dhe shkencës myslimane është ende duke u zbuluar nga shumë studiues në Perëndim. Mbetet një sfidë për studiuesit perëndimorë, të cilët mund të ndjehen tepër të kënaqur me një histori të rregullt të rritjes së shkencës në Evropën Perëndimore, për të marrë parasysh jo vetëm ekzistencën e këtyre arritjeve të hershme islame, por edhe për të marrë parasysh se çfarë roli luajtën ata në ngritjen e përgjithshme të shkencës moderne.[\[13\]](#)

Shkenca filloi me mjekët, filozofët dhe përkthyesit nestorianë nën regjimin Abasid

Kontributi i krishterë nestorian në zhvillimet në mjekësi, shkencë dhe filozofi në dhe rreth Bagdadit nga viti 786 deri në 1258 të erës sonë ishte i rëndësishëm. Le Coz madje ka sugjeruar se atyre i duhet njohur kryesisht merita për ngritjen e shkencës gjatë kësaj periudhe.^[14] Edhe pse Le Coz duket se e mbivlerëson argumentin e tij, në kurriz të theksimit të kontributeve të shquara myslimane të kësaj periudhe, figura të tilla si Hunejn ibn Ishaq, Is'haq ibn Hunejn, Uhanna Ibn Sarabijum, Xhibrail ibn Bukhtishu dhe shumë të tjerë të krishterë të shquar nestorianë sigurisht që luajtën një rol të rëndësishëm.

Shkenca moderne e filloi ngritjen e saj me filozofinë greke dhe kthesën e saj drejt monoteizmit.

Duke shkuar edhe më mbrapa, nuk mund të injorojmë faktin se vetë filozofët grekë, të cilët ishin kaq ndikues për format kryesore të shkencës moderne, bënë hapat që bënë pikërisht në kohën kur po lëviznin intelektualisht larg politeizmit mbizotërues të kulturës së tyre dhe drejt një monoteizmi filozofik. Është e qartë se shkrimet e grekëve, veçanërisht ato të Aristotelit, luajtën një rol kryesor në epokën e artë të filozofisë islame dhe në ngritjen e universiteteve në Evropën e shekullit të 13-të dhe përparimin e mëpasshëm drejt revolucioneve shkencore të shekujve 16-të dhe 17-të. Ne priremi t'i ndajmë këto arritje nga përparimet e mëvonshme shkencore, por ato në shumë mënyra ishin parakushtet e nevojshme për atë që pasoi. Ndërsa besimi i Aristotelit në një shkak të parë, ose një shtytës kryesor, nuk ishte një besim i përkushtimit fetar, lëvizja intelektuale drejt besimit në një hyjni të vetme (edhe pse jo domosdoshmërisht krijuesi i të gjitha gjërave) ishte sigurisht më shumë se një komponent i rastësishëm i botëkuptimit të tij. Për ata që mbështesin pikëpamjen se monoteizmi luajti një rol të rëndësishëm në ngritjen e shkencës, lëvizja drejt monoteizmit filozofik, midis filozofëve grekë, kërkon më shumë vëmendje.

Pjesa e dytë: Kundërshtimet ndaj teorive që e konsiderojnë monoteizmin faktor kryesor në ngritjen e shkencës moderne

Kundërshtimi 1: Teoritë konkurruese anulojnë njëra-tjetrën

Fakti që hapa të rëndësishëm drejt shkencës moderne u bënë në një sërë kontekstesh të lidhura me botëkuptimet monoteiste, ka shërbyer për të kundërshtuar pretendimet tepër të sigurta se ngritja e shkencës është e lidhur vetëm ose kryesisht me një traditë të vetme monoteiste. Megjithatë, në të njëjtën kohë, kundërshtarët e pikëpamjes se ekziston një lidhje midis monoteizmit dhe rritjes së shkencës kanë argumentuar se fakti që këto hapa janë bërë në një sërë kontekstesh monoteiste, por jo në të gjitha kontekstet monoteiste në të gjitha periudhat, sugjeron që lidhja është thjesht e rastësishme. Teoritë e ndryshme të rritjes së shkencës dhe lidhjes me traditat monoteiste, në sajë të parokializmit të shumë prej tyre, funksionojnë vetëm për të anuluar njëra-tjetrën. Provat janë shumë të forta për të mohuar një lidhje. Por pse, atëherë, hapat drejt shkencës moderne nuk ndodhën në të gjitha kulturat monoteiste? Pse zhvillimi i shkencës ndodhi pak brenda krishterimit deri në shekullin e 13-të, dhe më pas kryesisht vetëm në Perëndim? Përse nuk vazhdoi të ndodhte më shumë zhvillim mes disa prej shoqërive të hershme myslimane që bënë hapa kaq mbresëlënës të hershëm? Ose përse, në historinë e gjatë të judaizmit, para ngritjes së monoteizmit të krishterë dhe islam, asgjë e ngjashme si shkenca moderne nuk morri hov?^[15] Përgjigja më e qartë për këto pyetje është se ekzistenca e një botëkuptimi të fortë monoteist, edhe pse i rëndësishëm, nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të shpjeguar ngritjen e shkencës moderne në fazat e saj të ndryshme. Faktorë të tjerë gjithashtu duhet të merren parasysh. Stabiliteti politik, liria intelektuale, prosperiteti relativ ekonomik dhe kultura e të mësuarit, madje edhe shpikja e shtypshkronjës, duket se kanë qenë të gjitha faktorë jetësorë. Megjithatë, fakti që prania e thjeshtë e besimit monoteist nuk çoi gjithmonë drejt hapave të mëtejshëm në rrugën drejt shkencës moderne, nuk do të thotë se ky besim nuk dha një kontribut jetik.

Kundërshtimi 2: Përparime shkencore u bënë edhe në kulturat jomonoteiste.

Është e mirënjohur për historianët e qytetërimeve të lashta se jemi duke përmirësuar vazhdimisht vlerësimin tonë për arritjet teknike dhe aftësitë e shoqërive antike. Grekët e hershëm, persët, babilonasit, indianët dhe kinezët, për të përmendur vetëm disa nga më të shquarit, ishin të aftë për bëmat e mëdha të ndërtimit dhe inxhinierisë që kërkonin kuptim të avancuar të matematikës, gjeometrisë, punimit të metaleve etj. U formua qelqi, u prodhuan pasqyra, elektriciteti madje duket se ka qenë i njohur. U bënë vëzhgime jashtëzakonisht të sakta të yjeve (shpesh për qëllime astrologjike) dhe një njohuri mjekësore dhe anatomike ishte e disponueshme që nuk kishin të barabartë për shumë shekuj.

Nëse të gjitha këto gjëra u arritën në kultura që në atë kohë nuk ishin monoteiste, atëherë a mund të argumentojmë vërtet se monoteizmi kontribuoi në ndonjë gjë thelbësore në ngritjen e shkencës? Është thelbësore si për argumentin që po bëhet këtu në lidhje me monoteizmin dhe shkencën, ashtu edhe për një kuptim të historisë së shkencës, që të bëhet dallimi midis shkencës dhe teknologjisë. Të dyja janë të lidhura ngushtë. Përparimet në të kuptuarit shkencor në përgjithësi pasohen nga përparimet në teknologji. Por të dyja nuk janë njësoj. Sado mbresëlënëse të jenë kuptimet e avancuara të matematikës dhe gjeometrisë, ose aftësitë e nevojshme për të parashikuar një eklips të diellit, ose njohuritë bazë të fizikës që kërkohen për shumë makineri luftarake të lashta – kjo njohuri dhe aftësi në

vetvete nuk kualifikohet si shkencë në kuptimin e plotë. Ajo që duket se ka munguar në shumicën e këtyre shoqërive është kërkimi për të kuptuar se pse gjërat funksionojnë ashtu siç funksionojnë dhe se si njohuritë e këtyre funksioneve të ndryshme janë të ndërlidhura, si dhe një metodologji e artikuluar për të zgjeruar të kuptuarit tonë për botën natyrore. Në një farë mase këto lloj pyetjesh duhet të kenë qenë të pranishme – por ato nuk duket se janë ndjekur dhe integruar vazhdimisht me një botëkuptim të përgjithshëm. Kjo duket se ka ndodhur seriozisht vetëm në kontekste të ndryshme monoteiste.

Kundërshtimi 3: Format e ndryshme të monoteizmit në Judaizëm, Krishterim dhe Islam e bëjnë të vështirë pretendimin e monoteizmit si një faktor të përbashkët (në zhvillimin e shkencës).

Është argumentuar se ndryshimet në format e monoteizmit midis Judaizmit, Krishterimit dhe Islamit sugjerojnë se nuk ka një lidhje të përbashkët në ndikimin që ata do të kishin kontribuar në ngritjen e shkencës. Dihet mirë se të tre traditat kanë, ndonjëherë edhe brenda vetes, mënyra shumë të dallueshme për të kuptuar mënyrën se si vepron Zoti në botë. Duke nisur nga format e atomizmit deri te idetë e teologjisë së procesit në disa forma të mendimit të krishterë. Ndoshta edhe më bazik është fakti se studiuesit hebrenj dhe myslimanë kanë vënë në pikëpyetje se sa vërtet monoteist është besimi i krishterë duke pasur parasysh përkushtimin e tij ndaj doktrinës së Trinitetit. Ka shumë punë për të bërë në këtë fushë, por mendoj se secila prej traditave monoteiste duhet të jetë e hapur ndaj respektimit të përkushtimit ndaj njëshmërisë dhe unitetit të Zotit të shprehur në traditat e tjera. Edhe nëse e kemi të vështirë për ta kuptuar formën e kësaj shprehjeje, ndikimi në pikëpamjen tonë për botën, të paktën në lidhje me çështjen në fjalë, duket se ka qenë pothuajse i njëjtë.

Nëse ne besojmë se Zoti vepron vetëm përmes shkaqeve natyrore, në atë që disa e përshkruajnë si një model jo-ndërhyrës, ose besojmë se çdo veprim dhe lëvizje e vetme e çdo molekule përcaktohet nga Zoti, ndikimi në qasjen tonë ndaj botës natyrore ka ngjashmëri thelbësore. Besimi në një racionalitet hyjnor që krijon një botë të kuptueshme dhe racionale është i pranishëm në të gjitha rastet. Kështu është edhe kërkimi për të kuptuar proceset fizike të botës. Ata që kanë qenë shumë më rrënjësisht deterministë në kuptimin e tyre, qofshin atomistë myslimanë apo puritanët kalvinistë të Anglisë, duket se nuk janë frenuar të bëjnë pyetje për natyrën mbi bazën se Zoti përcakton çdo veprim dhe proces. Në çdo rast krijimi shihet si i ndryshëm nga Zoti, i cili supozohet se do të veprojë ose do të krijojë botën që të silllet në një mënyrë të rregullt dhe të modeluar, të arritshme për të kuptuarit tonë. Sado që mund të dëshirojmë të mendojmë se versioni ynë i veçantë i monoteizmit i jep një avantazh unik përpjekjes shkencore, e vërteta duket se është se çfarëdo qoftë ajo që ka të bëjë me monoteizmin, që mund të ketë luajtur një rol kritik në ngritjen e shkencës, ajo gjë është e përbashkët për konceptin bazik të një Zotit të vetëm dhe nuk varet nga një shprehje e veçantë (doktrinare) e këtij besimi.

Kundërshtimi 4: Feja (duke përfshirë monoteizmin) në fakt kundërshtoi përparimin e shkencës.

Ky kundërshtim tashmë është prekur më herët në punim, kur theksuam se shumë nga historitë e kundërshtimit të shkencës nga udhëheqësit dhe institucionet fetare janë ekzagjeruar disi. Mbetet, për fat të keq, një bërthamë e fortë e së vërtetës pas këtij kundërshtimi. Ka pasur vërtet raste të kundërshtimit ndaj shkencave dhe shkencëtarëve individualë. Ndoshta nuk është për t'u habitur që udhëheqësit fetarë, pasi panë ndikimin në rritje të shkencës, ndonjëherë u përpoqën ose ta ndalonin ose ta kontrollonin shkencën. Megjithatë, këto raste nuk e mohojnë rolin që luan besimi monoteist në ngritjen e shkencës, por përfaqësojnë shumë më tepër një reagim politik ndaj një humbjeje të perceptuar dhe ndonjëherë reale të ndikimit dhe fuqisë. Sido që të jetë përgjigjur një zyrtar fetar, fakti mbetet, siç shprehet Harold Nebelsick, se “forca kryesore motivuese pas kërkimit të njohurive natyrore nga koha e Babilonisë dhe Greqisë në Lindje deri në kohën e Rilindjes në Perëndim ishte teologjike dhe jo shkencore.”^[16]

Kundërshtimi 5: Jo të gjitha kulturat monoteiste treguan prova se janë të interesuara për mendimin shkencor

Nëse kishte diçka të veçantë rreth fesë dhe mendimit monoteist që ofronte një terren pjellor për ngritjen e shkencës, atëherë pse kaq shumë kultura monoteiste shfaqën pak ose aspak gjurmë të prirjeve të tilla? Krishterimi mesjetar deri në shekullin e 13-të, shoqëritë islame jashtë Abasidëve dhe lulëzimi i mëvonshëm në Spanjën Jugore dhe shumica e zonave ortodokse të Evropës Lindore treguan pak prova të gjenerimit të përparimeve në të menduarit shkencor, pavarësisht angazhimeve shumë të forta ndaj fesë monoteiste. Kjo duket të nënkuptojë se duhet kërkuar një arsye tjetër përveç besimit monoteist për të shpjeguar se çfarë lloji shkence lindi brenda konteksteve të tjera monoteiste.

Nga ana tjetër, mund të argumentohet se kishte mangësi të të kuptuarit dhe praktikës monoteiste në këto fusha që do të shpjegonin mungesën e përparimit në të menduarit shkencor. Në pjesën më të madhe, shembujt e prodhuar janë tregues të regjimeve shumë konservatore në të cilat uniteti fetar u zbatua dhe liria akademike nuk inkurajohej. Siç shihet edhe në seksionin vijues, monoteizmi i shëndoshë dhe i kuptuar siç duhet shkon krahas për krahas me tolerancën dhe lirinë intelektuale. Aty ku këto janë shtypur, aspektet pozitive të monoteizmit që kanë inkurajuar hetimin shkencor të botës fizike nuk kanë qenë në gjendje të lulëzojnë dhe nuk kanë dhënë asnjë kontribut në ngritjen e shkencës.

Pjesa e tretë: Argumentet në favor të tezës se monoteizmi ka qenë një faktor thelbësor kontribues në ngritjen e shkencës në fazat e saj të ndryshme.

Ndoshta argumenti më i fortë për rastin e rolit të monoteizmit në ngritjen e shkencës qendron tek rëndësia e shpjegimit. Vetë metoda shkencore i jep shumë rëndësi shpjegimit. Sa më shumë të dhëna të shpjegojë një teori, aq më shumë peshë i jepet teorisë. Nëse teoria monoteizëm-shkencë është e

saktë, atëherë nevojitet më shumë sesa një seri lidhjesh historike intriguese, të cilat në fund të fundit mund të jenë vetëm rastësi. Pyetja kritike është: Çfarë avantazhesh apo disavantazhesh specifike i dha monoteizmi ngritjes së shkencës dhe në çfarë mase ndihmojnë këto avantazhe për të shpjeguar ngritjen e shkencës në format dhe fazat e saj të ndryshme që nga koha e grekëve të lashtë, deri në periudhën e artë, përmes epokës së artë të filozofisë myslimane, deri te shpërthimi i përparimeve shkencore që dolën nga Evropa e krishterë e shekullit të 16-të dhe 17-të?

Monoteizmi krijoi një kontekst në të cilin mund të bëheshin pyetje për botën natyrore.

Monoteizmi nga vetë natyra e tij inkurajoi shtrimin e pyetjeve rreth funksioneve të botës natyrore. Në botëkuptimet politeiste që dominonin pjesën më të madhe të botës antike, kishte pak koncept të laicitetit. Çdo gjë kishte perëndinë ose frymën e saj dhe çdo ngjarje mund të shpjegohej nëpërmjet veprimeve të hyjnive të ndryshme. Qoftë zi buke, përmytje apo shpërthim vullkanik, çelësi për të kuptuar atë që kishte ndodhur – dhe nëse ishte negative për të parandaluar përsëritjen e saj – ishte të kuptonim funksionimin e hyjnive të ndryshme. Max Weber thekson se ky desakralizim i botës hodhi bazat për një qasje shkencore ndaj botës. Por përse kështu? Dikush mund të mendojë se monoteizmi, veçanërisht ato forma me pohime të forta të sovranitetit të Zotit, nuk do të kish qenë shumë më ndryshe nga politeizmi në prirjen për t'i atribuar të gjitha shkaqet drejtpërdrejt veprimeve të një hyjnie të vetme, duke eliminuar nevojën për të bërë pyetje rreth shkaqeve natyrore. Nëse një përmytje ose thatësisht ndodh, atëherë pse u zemërua Perëndia dhe çfarë duhet të bëjmë për ta qetësuar atë? A nuk i bashkoi monoteizmi thjesht funksionet e hyjnive të ndryshme konkurruese në një paketë? Por kjo nuk është ajo që ndodhi. Ndërsa ka sigurisht përjashtime, në shumicën e rasteve besimi në një Zot – veçanërisht një Zot sovran të plotfuqishëm, të gjithëdijsëm, i bëri njerëzit të shikojnë gjithnjë e më shumë drejt shkaqet natyrore. Një Zot i plotfuqishëm, sovran, ndonëse sigurisht i aftë për të ndërhyrë – në të vërtetë për të kryer mrekulli – do të krijonte dhe do ta qeveriste botën në një mënyrë të tillë që të ndiqte zakonisht modele të rregullta dhe për këtë arsye të kuptueshme. Nëse natyra nuk është në vetvete hyjnore, por krijimi i të Vetmit hyjnor, atëherë ne mund t'i drejtojmë pyetje natyrës – madje të bëjmë eksperimente mbi të.

Monoteizmi dhe uniteti i dijes.

Kontributi i dytë madhor i mendimit monoteist ishte theksimi i tij mbi unitetin e dijes. Doktrina muslimane e Teuhidit (njëshmërisë së Zotit) është e njohur. Uniteti i Zotit kishte implikime për unitetin e asaj që Zoti krijon dhe për unitetin e njohjes së botës së krijuar. Ishte përkushtimi ndaj doktrinë së teuhidit që motivoi shumë nga filozofët e hershëm myslimanë. Mendimtarët e krishterë gjithashtu panë lidhjen midis njëshmërisë së Zotit (edhe pse e kuptuar në formën Trinitare) dhe unitetit të njohurive për botën e krijuar nga Zoti. Nëse një qenie e vetme hyjnore ishte përgjegjëse për të gjithë rendin e krijuar natyror, atëherë të gjitha njohuritë për botën natyrore duhet të jenë thelbësisht të ndërlidhura. Mendimtarët monoteistë jo vetëm që prireshin të kërkonin shkaqe dhe shpjegime natyrore (pa refuzuar Zotin si shkakun përfundimtar të të gjitha gjërave), por gjithashtu t'i shihnin këto shkaqe si të lidhura

thelbësisht – duke pasur një bazë të përbashkët në Zotin e vetëm krijues. Monoteizmi duket se jo vetëm i ka lënë njerëzit të lirë të pyesin rreth natyrës, të cilat janë të nevojshme për shfaqjen e shkencës, por ai gjithashtu, nga vetë natyra e tij, sugjeron një pikëpamje unitare të botës dhe njohurive të botës që ka rezultuar jetike për ngritjen e shkencës – nga filozofët grekë, në epokën e artë të filozofisë dhe shkencës myslimane, deri tek revolucionet në të menduarit shkencor në Evropën Perëndimore.

Mendja e Zotit dhe rendi natyror.

Një supozim thelbësor i monoteizmit është se një mendje logjike do të prodhojë një botë logjike. Nëse mendja e Zotit është koherente dhe e kuptueshme, atëherë bota që krijon Zoti gjithashtu duhet të jetë e tillë dhe njerëzit mund t'i afrohen dhe ta hetojnë atë me shpresën se ajo mund të kuptohet. Kjo tendencë për t'i grejtuar pyetje botës natyrore nuk ishte vetëm rezultat i lirisë që monoteizmi prirej të jepte për të bërë pyetje të tilla, por edhe erdhi në ekzistence nga besimi në inteligjencën hyjnore. Nëse Zoti është racional, atëherë duhet të ketë një kuptueshmëri të natyrshme në univers. Siç ka theksuar John Hedley Brooke, hetimi i shekullit të 17-të për të gjetur ligjet e natyrës mund të shihet gjithashtu si një kërkim për të zbuluar legjislacionin hyjnor që qëndron pas rregullive të natyrës^[17].

Monoteizmi dhe liria intelektuale

Megjithëse shembujt e shtypjes së lirisë intelektuale midis traditave monoteiste janë të shumtë, mund të argumentohet se dokumentet burimore të monoteizmit abrahamik, si dhe supozimet themelore të monoteizmit filozofik, çojnë në një drejtim tjetër. Një Zot, ekzistenca dhe fuqia e të cilit nuk varen nga përkushtimi ynë dhe që nuk kërkon mbrojtjen tonë, është një Zot që mund të merret në pyetje (krh. Job) dhe që mund t'i përgjigjet dyshimit me prova dhe jo me kërcënim (krh. tregimin e Thomait). Monoteizmi i shëndetshëm prodhon besim të mjaftueshëm te ithtarët e tij për të qenë në gjendje të jetojnë me diversitet fetar dhe intelektual. Fatkeqësisht, natyra njerëzore shpesh e ka shtypur këtë prirje të monoteizmit, por kur ajo është kuptuar drejt (p.sh., në Epokën e Artë të Islamit nën Abasidët), ndikimi në përparimin e të menduarit shkencor ka qenë i thellë.

Monoteizmi, popujt e librit dhe shkrim-leximi.

Studime të shumta janë bërë mbi ndikimin e mbështetjes së hebrenjve, të krishterëve dhe myslimanëve tek tekstet e tyre të shenjta. Roli që këta 'libra' kanë luajtur në fetë klasike monoteiste kanë shërbyer edhe si një shtysë e madhe për shkrim-leximin. Ekzistenca e shkruarve dhe e

audiencave të shkolluara për të lexuar librat që ata kopjuan, nënkuptonte se edhe ide të tjera mund të shkruheshin më lehtë dhe të shkëmbeheshin midis kulturave dhe të përcilleshin ndër breza.

Përmbledhje e argumentit.

Si përmbledhje, shkenca moderne dhe kultura kërkimore e lidhur me të, lindën, në një masë të madhe, për shkak të: (1) lirisë së ofruar nga botëkuptimet monoteiste për të bërë pyetje rreth 'si' dhe 'pse' e botës natyrore (se këto nuk supozohej më të kontrolloheshin nga hyjni të ndryshme lokale); (2) supozimi se një mendje logjike do të krijonte një botë fizike që ishte gjithashtu logjikisht e kuptueshme; dhe (3) supozimi se një Zot i vetëm krijues nënkupton që e gjithë njohuria e botës fizike duhet të jetë e ndërlidhur. Këta faktorë shpjegojnë pse të gjithë hapat më të mëdhenj në shkencën moderne, nga Platoni dhe Aristoteli, tek mendimtarët e hershëm të krishterë dhe hebrenj, në epokën e artë të Islamit, deri në shpërthimin e zbulimeve shkencore midis katolikëve dhe protestantëve evropianë nga shekulli i 16-të deri në shekullin e 18-të, ndodhën kur mendimi monoteist ishte më i fortë dhe më dominues në të menduarit intelektual të asaj kohe. Pa këto kontribute kyçe të besimit monoteist, nuk kishte gjasa që të lindte shkenca moderne dhe kultura kërkimore e lidhur me të.

Përktheu: Rezart Beka

Referenca

[1] Wolfhart Pannenberg, fjala vjen, ka argumentuar se "Nëse Zoti I Biblës është krijuesi I university atëherë nuk është e mundur që të kuptojmë plotësisht apo edhe përafërsisht proceset e natyrës pa referencë Zotin. Nëse është e kundërta atëherë natyra mund të kuptohet pa referencë Zotin e Biblës dhe atëherë Zoti mund të mos jetë krijuesi I universit." Pannenberg, "Theological Questions to Scientists" in *The Sciences and Theology in the*

Twentieth Century, ed. A Peacocke. (Notre Dame, IN: University of Notre Dame Press 1981), 4.

[2] John William Draper, *History of Conflict between Religion and Science* (London: Henry S King 1875), 367

[3] Cf Andrew Dickson White, *A history of the Warfare of Science With Theology in Christendom*, 2 vols (New York, D Appleton and Company, 1896)

[4] Fred Hoyle *Nicolas Copernicus: An Essay on His Life and Work* (London; Heinesmann, 1973) 32 f

[5] Cf. Robert K. Merton, *Science, Technology, and Society in 17th Century England* (1938); Christopher Hill, *The Intellectual Origins of the English Revolution* (Oxford: Clarendon Press, 1965):

and Charles Webster, *The Great Instauration: Science, Medicine and Reform 1626-1660* (London: Duckworth, 1975).

[6] R. Hooykaas. *Religion and the Rise of Modern Science*. Edinburgh: Scottish Academic Press, 1972.

[7] Cf. David Knight, *Copernicus*. London: Franklin Watts, 1965, pp. 192f

[8] Shih kapitullin 'Luther on the Border of Superstition and Science,' in M. Worthing, *Martin Luther. A Wild Boar in the Lord's Vineyard*. Morning Star Press, 2017, pp. 141ff.

[9] Cf. Peter Harrison, in his book *The Bible, Protestantism and the Rise of Natural Science* (Cambridge University Press, 1998).

[10] Cf. Gary Deason, "Reformation Theology and the Mechanistic Conception of Nature," in *God and Nature*, 172.

[11] Ka një diskutim analog tejet interesant në impaktin e diskutimit talmudik në mendjen judaike në shpjegimin e suksesit të madh të shahut që në nivelet e larta ka shumë lojtar hebrenj. Shih fjala vjen, David Spanier, *Total Chess*, 1984.

[12] Stephen Mason, *A History of the Sciences* (New York: Macmillan, 1962), 95ff. and S. Nomanul Haq, "Moments in the Islamic Recasting of the Greek Legacy: Exploring the Question of Science and Theism," in T. Peters, M. Iqbal and S. Haq, eds., *God, Life, and the Cosmos: Christian and Islamic Perspectives*. Ashgate 2002

[13] Muhammad Saud, *the Scientific Method of Ibn Al-Hyatham*. Islamic Research Institute, Islamabad, 1990 and S. Nomanul Haq, "Moments in the Islamic Recasting of the Greek Legacy: Exploring the Question of Science and Theism," in T. Peters, M. Iqbal and S. Haq, eds., *God, Life, and the Cosmos: Christian and Islamic Perspectives*. Ashgate 2002.

[14] Cf. Le Coz, R. *Les médecins nestoriens au Moyen Âge: Les maîtres des Arabes*. L'Harmattan, 2004

[15] Gjithsesi duhet të kemi parasysh se mendimtarët hebrenjw kanë luajtur një rol kyç në periudhat kyçe të zhvillimit të shkencës moderne. Në kulmin e epokës së artë të shkencës për myslimanët Maimondes ishte një filozof i famshëm dhe një ekspert mjekësor që shkoi nga Spanja myslimane për të shërbyer si mjek personal i Salahudinit. Filozofi hebre dhe shkencëtar gjithashtu luajti një rol kyç në shpërndarjen e mendimit shkencor që nisi të përhapej në Europë nga shekulli 17. Judaizmi edhe në diasporë, luajti një rol kyç në ngritjen e shkencës.

[16] Harold Nebelsick. *Circles of God: Theology and Science from the Greeks to Copernicus*. (Edinburgh: Scottish Academic Press, 1985), xiii.

[17] John Hedley Brooke, *Science and Religion: Some Historical Perspectives*

Date Created

27/11/2021

Author

erasmusi